



**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
POGRADEC**

Nr.00659 - 627 Prot.

Pogradec 25.06.2020

**SHPALLJE VENDIMI**

**Drejtuar: Njesia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.**

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec ka përfunduar faza I e gjykimit të çështjes civile me Nr.00659-627 regjistri, date regjistrimi 27.12.2019; nr.s'ka vendimi, dt.24.06.2020 me pale:

**PADITES:** Ezmeralda Refugjati  
**I PADITUR:** Bardhi Tatush  
**P.TRETE:** -  
**OBJEKTI:** Pjestim pasurie

Kjo shpallje sipas nenit 133/a, 133/b të K.Pr.Civile ze vendin e komunikimit të Vendimit Nr.s'ka, dt.24.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për të paditurin

- 1. Bardhi Agron Tatush banues në fshat Rrembec, Njesia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.**

për të cilin gjatë gjykimit ka rezultuar se nuk ndodhet në adresën e dhënë në kërkesepadi por është larguar në adrese të pacaktuara, nuk ka zgjedhur një përfaqësues për gjykim dhe gjatë gjykimit është njoftuar me shpallje nepermjet afishimit të njoftimit, si dhe do të botohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

Kjo shpallje ze vendin e komunikimit të vendimit për këto shtetas.

***Kjo shpallje ju dërgohet në 4 kopje, si organ i qeverisjes vendore të bëni afishimin e saj në vendin e afishimit Njesia Administrative Pojan, Bashkia Maliq, një kopje të afishohet tek banesa e të paditurit Bardhi Tatush fshat Rrembec, Njesia Administrative Pojan, Bashkia Maliq, ndërsa kopjen tjetër t'ia ktheni gjykatës duke bërë shënimin që është afishuar. Nënshkrimi të jetë i plotë (emër, mbiemër, firmë, vulë).***

***Bashkëlidhur po ju dergojmë një kopje të vendimit.***

- Kry. Ad. Pojan  
- Drij. Sek. Jof. Publik ✓  
29.06.2020



M. 86 Prot  
Dt. 29.06.2020



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR POGRADEC

Nr.Regj. 00659- 627  
Dt.regj. 27.12.2019

Nr.vend. ska  
Dt.vend.24.06.2020

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Pogradec, e përbërë prej:

- Kryetar i seances gjyqesore Artan JAHOLLARI

asistuar prej sekretares gjyqësore Frida Meko, në Pogradec, sot më dt.24.06.2020, ora 10:00 h, mori në shqyrtim ne séancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që iu përket:

**PADITËSE:** **Ezmeralda Refugjati** e bija e Fiqiri dhe Mevlude, dtl.06.07.1985, banues në fshatin Rëmbec, Bashkia Maliq, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nga av.Meto Balli antar i Dhomës së Avokatisë Korçë.

**I PADITUR:** **Bardhi Tatush** i biri i Agron dhe Aleksandra, dtl.29.09.1980, banues në fshatin Rëmbec, Bashkia Maliq. *(Gjykuar në mungesë, me shpallje, shih fletëthirrjen dhe shpalljet në dosjen gjyqësore).*

**OBJEKTI:** Pjestim pasurie.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 222 e vijues të Kodit Civil. Neni 360 e vijues i K. Civil. Neni 207 i Kodit Civil. Neni 32 i K.Pr.Civile.

Në përfundim të gjykimit të fazës së parë të pjestimit, gjykata, pasi administroi provat e paraqitura në gjykim dhe dëgjoji pretendimet e palëve, si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi:

VËREN:

**I. PROCEDURA**

1. Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të padisë, gjykata kryesisht mori në shqyrtim juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Në bazë të neneve 36/1, 41 dhe 44 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata konstatoi se çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, pasi sendet e paluajtshme ndodhen në teritorin , ku ushtron veprimtarinë tokësore kjo gjykatë.

## II. RRETHANAT E ÇËSHTJES

2. Padiësia dhe i padituri kanë qenë bashkëshortë njëri me tjetrin, kanë lidhur martesë më dt.18.11.2002 dhe kanë zgjidhur martesën me vendimin nr.(41)-20, dt.23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë i cili ka marrë formë të prerë më dt.04.05.2018, pasi nuk është ankimuar nga palët.
3. Pas zgjidhjes së martesës me vendim të formës së prerë, padiësia kërkon pjestimin e pasurisë së përbashkët dhe konkretisht të pasurisë me nr.397/167+1-4, vol 20, faqe 194, ZK 1298, e ndodhur në fshatin Buçimas, Pogradec. Referuar kartelës së pasurisë, rezulton se, kjo pasuri është e llojit apartament, me sipërfaqe totale 99 m2 dhe e regjistruar në emër të padiësës Ezmeralda Refugjati dhe të paditurit Bardhi Tatush.
4. Rezulton se, pasuria objekt gjykimi është blerë nga i padituri Bardhi Tatush me kontratën e shitblerjes me nr.530 rep, nr.320 kol, dt.22.03.2008 me shitës Eduard Kuqo. Pas lidhjes së martesës, A.SH.K.Pogradec në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën” ka urdhëruar që në kartelën e pasurisë të përfshihej edhe bashkëshortia Ezmeralda Refugjati e paditurit Bardhi Tatush.
5. Padiësia kërkon që ti lihet në pronësi pasuria objekt gjykimi, kundrejt detyrimit që ti paguajë bashkëshortit  $\frac{1}{2}$  e vlerës së pjesës takuese. Padiësia e mbështet kërkimin e saj në nenin 207/2 të K.Civil, me arsyetimin se, nga zgjidhja e martesës të dy fëmijët i janë lënë për rritje dhe edukim dhe si rrjedhim ka më shumë nevojë për mbajtjen e kësaj pasurie, për nevoja banimi.

## III. VLERËSIMI I GJYKATËS

6. Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të padisë, gjykata kryesisht mori në shqyrtim juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Në bazë të neneve 36/1, 41 dhe 44 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata konstatoi se çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
7. Gjykata përpara se të përcaktojë nëse pasuria objekt gjykimi do t'i nënshtrohet pjestimit vlerëson të theksojë disa përfundime unifikuese, që kanë arritur Kolegjet e Bashkuara me vendimin Nr.628/2000.
8. Vendimi i ndërmjetëm, për fazën e parë të pjestimit, është vendim i një lloji të veçantë, sui generis, është një vendim i cili pasi merr formës së prerë, problemet e zgjidhura me të, përbën gjë të gjykuar, përfundim unifikues i cili është arritur nga Kolegjet e Bashkuara, duke u shprehur se:
  - *“Vendimi i fazës së parë të pjestimit të pasurisë nuk është i njëjtë për të gjitha efektet me vendimet e tjera të ndërmjetme që jepen gjatë gjykimin të një çështje, sipas përcaktimeve që bëhen në nenet 125 dhe 315 të K.Pr.Civile. Sipas nenit 125 të K.Pr.Civile, “Vendimet*

e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancën gjyqësore, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi”, ndërsa, sipas nenit 315 të K.Pr.Civile, që mban titullin “Vendimet e ndërmjetme”, “Vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë perfundimtare, mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveç kur në këtë kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë”. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave të sipërcituara arrijmë në përfundimin se vendimet e ndërmjetme si rregull janë të karakterit procedural, jepen gjatë gjykimit të çështjes, nuk janë perfundimtare, dhe, si rregull, nuk kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjes në themel”.

- “Ne dallim nga karakteristikat e mësipërme, vendimet e fazes së parë të pjestimit, të cilat i kemi cilësuar me lart si vendime të ndërmjetme të një lloji të veçante (sui generis), nuk janë vendime të karakterit thjesht procedural, d.m.th. nuk jepen vetëm për të siguruar normalitetin e zhvillimit të gjykimit brenda kërkesave të normave procedurale. Nisur nga karakteri i posaçëm i gjykimit të çështjeve me objekt pjestim pasurie dhe i ndarjes së tij në dy faza të veçanta, ligjvënësi e ka çmuar të nevojshme dhe të dobishme që disa probleme t’i zgjidhë në themel dhe në mënyrë përfundimtare” me vendim të ndërmjetëm në mbyllje të fazës së parë”.
- “Gjersa në rastet e mësipërme vendimi i fazës së parë merr formë të prerë, problemet e zgjidhura me të përbëjnë gjë të gjykuar dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund t’i nënshtrohen një shqyrtimi të ri në fazën e dytë të pjestimit në cilido shkallë të gjykimit (shkallë e parë, Apel apo Gjykate e Lartë) që të ketë kaluar çështja. Bazueshmëria e një vendimi të formës së prerë nuk mund të kontestohet, veçse kur në Kodin e Procedures Civile parashikohet shprehimisht forma dhe mjete të posaçme për një gjë të tillë. Kundërshtimi i vendimit të fazes së parë të pjestimit të pasurisë së bashku me vendimin e fazës së dytë nuk parashikohet në ndonjë dispozitë të Kodit të Pr.Civile, as në mënyrë të shprehur, as të nënkuptuar”.

9. Probelemet që zgjidhen në fazën e parë të pjetimit janë parashikuar në nenin 370 të K.Pr.Civile i cili parashikon se: “Gjykata për pjestimin se sendeve në bashkëpronësi dhe në trshëgimi në fazën e parë të pjestimit, ka për qëllim të hetojë dhe të përcaktojë të drejtën e bashkëpronësisë të bashkëndërgjyqësve, pjesët e tyre takuese dhe sendet që do të pjestohen. Pasi të ketë marrë provat e nevojshme, gjykata me vendim të ndërmjetëm lejon pjestimin, duke përcaktuar rrethin e bashkëpjestarëve, sendet që do të pjestohen si dhe pjesët takuese të secilit prej tyre”.

10. **Gjatë gjykimit rezultoi e provuar se,** paditësia dhe i padituri kanë qenë bashkëshortë njëri me tjetrin, kanë lidhur martesë më dt.18.11.2002 dhe kanë zgjidhur martesën me vendimin nr.(41)-20, dt.23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë i cili ka marrë formë të prerë më dt.04.05.2018, pasi nuk është ankimuar nga palët.

11. **Gjatë gjykimit rezultoi e provuar se,** pasuria me nr.397/167+1-4, vol 20, faqe 194, ZK 1298, e ndodhur në fshatën Buçimas, Pogradec objekt gjykimi është blerë nga i padituri Bardhi Tatush, me kontratën e shitblerjes me nr.530 rep, nr.320 kol, dt.22.03.2008 me shitës Eduard

Kuqo. Pas lidhjes së martesës, A.SH.K.Pogradec në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën” ka urdhëruar që në kartelën e pasurisë të përfshihej edhe bashkëshortia Ezmeralda Refugjati e paditurit Bardhi Tatush. Aktualisht kartela e pasurisë është shënuar në emër të paditëses dhe të paditurit.

12. Gjykata vlerëson se, pasuria e mësipërme është një pasuri e fituar gjatë martesës, duke pasur parasysh faktin, që bashkëshortët kanë qenë të martuar, në kohën e materializimit të titullit të pronësisë, pasi referuar çertifikatës së martesës data e lidhjes së martesës është dt.18.11.2002, ndërsa kontrata e shitblerjes është realizuar në dt.22.03.2008 ku padituri ka pasur cilësinë e blerësit.

13. Kodi i Familjes është miratuar me ligjin nr.9062, dt.08.05.2003 dhe ka hyrë në fuqi më dt.21.12.2003, ndërsa martesë është lidhur më dt.18.11.2002 përpara se të hynte në fuqi Kodi i Familjes. Mirëpo në lidhje me regjimin pasuror martesor, gjykata i referohet dipsozitet kalimtare të këtij kodi nenit 315 i cili parashikon se: *“Pasuria që fitohet në bashkëpronësi nga bashkëshortët, pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, rregullohet nga ky kod edhe për martesën që është lidhur përpara hyrjes në fuqi të tij”*.

14. Pavarësisht se martesë është lidhur para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, ligjëvënësi regjimin pasuror martesor e ka shkëputur nga lidhja e martesës dhe rregullimin ligjor e lidh me momentin e krijimit të pasurisë pra duke zbatuar rregullin e përgjithshëm që, ligji zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tyre. Në rastin objekt gjykimi, pasuria është krijuar në vitin 2008 dmth pas hyrjes në fuqi të K.Familjes.

15. Pasuria e përmendur më sipër, konsiderohet si pasuri që i nënshtrohet regjimit të bashkëpronësisë bashkëshortore, në kuptim të nenit 74/a të K.F, i cili parashikon se: *“Bashkësia përbëhet nga pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç gjatë martesës”*.

16. Me të drejtë A.SH.K.Pogradec me urdhërin nr.62, dt.06.06.2019 ka urdhëruar që në kartelën e pasurisë të pasurisë objekt gjykimi, të shënohej edhe emri i paditëses bashkëshortes Ezmeralda Refugjati dhe në kuptim të nenit 74/a të K.Familjes, por edhe të insitutit që rregullon regjimin e bashkëpronësisë mes bashkëshortëve, pavarësisht se është në emër të njërit prej bashkëshortëve, ajo për efekt të prezumimit ligjor, konsiderohet pjesë e bashkësisë ligjore.

17. A.SH.K.Pogradec ka vepruar në respektim të parashikimeve të nenit 45 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” i cili parashikon në paragrafin e dytë, situatën kur është regjistruar një pasurië vetëm në emër të njërit prej bashkëshortëve, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligj, ndërkohë që pasuria është fituar gjatë martesës. Me konkretisht parashikohet se: *“Drejtoria Vendore korrigjon ose përditëson të dhënat kadastrale për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të dy bashkëshortëve, të fituara gjatë martesës, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rast se, kjo kërkohet me shkrim nga bashkëshorti që nuk është i regjistruar dhe vërtetohet nga çertifikata e gjendjes familjare, kur është fituar pasuria”*.

18. Përsa i përket pjesëve takuese, secili prej tyre përfiton në pjesë të barabarta ideale, mbi pasurinë objekt gjykimi, duke mbajtur parasysh përcaktimet e nenit 103/2 të K.F-së, i cili

parashikon se: "Pasi të jenë zbritur nga bashkësia detyrimet që ajo ka ndaj bashkëshortëve ose të tretëve, pasuria që mbetet ndahet në pjesë të barabarta mes bashkëshortëve".

19. Duke pasur parasysh përfudimet unifikuese të përmendura në pikën 11 të këtij vendimi, gjykata thekson se ky vendim pasi të marrë formë të prerë, përbën gjithë të gjykuar, përsa i përket çështjeve që janë zgjidhur me këtë vendim.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenin 306-309, 370 të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr.7501, dt.19.07.1991 "Për tokën"

#### VENDOSI:

- Të lejojë pjestimin pasurisë me nr.397/167+1-4, e llojit "apartament" me sipërfaqe 99 m<sup>2</sup>, vol 20, faqe 194, ZK 1298, e ndodhur në fshatin Buçimas, Pogradec, me pjesë takuese ½ secili prej paditëses Ezmeralda Refugjati dhe të paditurit Bardhi Tatush, për efekt të vijimit të gjykimit me fazën e dytë të pjestimit.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë. brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Korçë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njohimit të arsytuar për palën paditëse, për palën e paditur nga e nesërmja e afishimit të shpalljes.

U shpall në Pogradec sot me dt.24.06.2020

SEKRETARE

FRIDA MEKO

GJYQTARI

ARTAN JAHOLLARI

**Shenim:** Ky vendim ka marrë formë të prerë me dt. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_.

KANCELAR

Guri Sofi